

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6552  
E hënë, 7 mars 2022  
çmimi 0.40

## Mbi 1 000 raste aktive me Covid në Kosovë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE QENDRORE, LOKALE DHE PËRFAQËSUES TË PARTIVE POLITIKE KANË VIZITUAR PREKAZIN

# POROSIA E BACËS RIFAT: TË GJITHË BASHKË TË PUNOJTMË PËR ZHVILLIMIN E KOSOVËS



Përfaqësues të institucioneve qendrore, lokale dhe përfaqësues të partive politike kanë vizituar të dielën Prekazin me rastin e shënimit të 24-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes Jashari. Rifat Jashari ka pasur një porosi për të gjithë klasën politike. Ai ka thënë se të gjithë kanë dhënë për çlirimin e Kosovës, ndërsa tani të gjithë duhet të punojnë së bashku për zhvillimin e Kosovës

## AKTUALE



ERDOGANI I KËRKON PUTINIT TA SHPALLË ARMËPUSHIMIN NË UKRAINË F. 2

KOSOVA DHE SERBIA PRITET TË ARRIJNË MARRËVESHJE PËR ENERGJINË NË VERI DHE PËR PERSONAT E PAGJETUR F. 3

SOT NË PRISHTINË PROTESTOHET NË MBËSHTETJE TË UKRAINËS F. 6

## EKONOMI



NJË VALË E RE ÇMIMESH PRITET TA GODASË TREGUN E KOSOVËS F. 7

KRIZA NË TREGJET NDËRKOMBËTARE PREK PARATË E TRUSTIT F. 7

## SPORT



BALLKANI FITON DERBIN NDAJ LLAPIT, DRENICA FITON KUNDËR DRITËS F. 10

## Paralajmëron Uk Lushi: Serbia dhe Putini po përgatitin planin e ndërhyrjes në veri



## KIEVI DHE MOSKA, AKUZA TË NDËRSJELLA PËR DËSHTIMIN E EVAKUIMIT TË CIVILËVE

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 487 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Kievi dhe Moska, akuza të ndërsjella për dështimin e evakuimit të civilëve

Lufta Rusi - Ukrainë ka hyrë të dielën në ditën e 11-të. Moska po përgatit sulmin mbi Odessa, ndërsa armëpushimi i njoftuar një ditë më parë për hapjen e korridoreve humanitare ka dështuar. Njerëzit në Mariupol u detyruan të ktheheshin mbrapsht

**KIEV, 6 MARS (ER)** - Kjo e diel ka shënuar ditën e njëmbëdhjetë të luftës që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës. Përparimi i ushtrisë ruse është ngadalësuar ditët e fundit, por ende nuk është e qartë nëse kjo ka ndodhur si pasojë e rezistencës ukrainase apo ndryshimit të një strategjie ushtarake veçanërisht pas dështimeve të para të ushtrisë ruse. Në Mariupol, në juglindje të vendit, vazhdon rrethimi i qytetit, i cili prej gati një jave është pa ujë, pa energji elektrike dhe pa ngrohje. Armëpushimi i shpallur të shtunën nga Rusia nuk u respektua nga ushtria ruse, ndërsa evakuimi i njerëzve nga qyteti ishte i pamundur. Në veri të vendit ushtria ruse po përpaket ta rrethojë Kievin, ndërsa mësohet se konflikti është përshkallëzuar në periferi të qytetit. Sulmet dhe bombardimet ndaj popullatës civile vazhdojnë edhe në pjesën tjetër të vendit.

Për të dytën ditë me radhë planet për evakuimin e civilëve nga qyteti Mariupol kanë dështuar, kanë thënë zyrtarët ukrainas, teksa të dyja palët kanë fajësuar njëra-tjetrën. Banorët do të duhej të evakuheshin nga Mariupoli nga ora 10:00 deri në orën 21:00 sipas kohës lokale, në bazë të një marrëveshjeje për armëpushim lokal. Por,

këshilltar i Ministrisë së Brendshme ukrainase, Anton Gerashchenko, tha se evakuimi është pezulluar për shkak të sulmeve të vazhdueshme nga trupat ruse. "Nuk ka 'korridore të gjelbra' sepse rusët vendosin vetë se kur do të nisin të shtënat dhe ndaj kujt", tha ai. Por, presidenti rus, Vladimir Putin, ka fajësuar palën ukrainase për dështimin e evakuimit nga Mariupoli, që është qytet port në juglindje të Ukrainës.

## Raportohet për civilë të vrarë nga granatimet në afërsi të Kievit

Mediet ndërkombëtare kanë raportuar të dielën se ka viktima në mesin e civilëve në Irpin, në veriperëndim të Kievit, të cilët po iknin nga bombardimet ruse. Të paktën tre persona raportohet se janë vrarë nga granatimet ruse, që kanë goditur një urë të dëmtuar, të cilën civilët e kanë përdorur për të ikur.

"The New York Times" raporton se tre anëtarë të së njëjtës familje janë vrarë. Kjo gazetë, po ashtu, njoftoi se një grup i vogël civilësh po vraponin në një rrugë dhe po ndihmoheshin nga ushtarët ukrainas që të arrinin në një pjesë të sigurt.

Pasi dëgjuan zhurma të shumta të granatimeve, gazetarët e



## OKB: Deri më tani janë konfirmuar 364 vdekje të civilëve në Ukrainë

Zyra për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara ka njoftuar se deri më tani ka konfirmuar vdekjen e 364 civilëve në Ukrainë që prej nisjes së pushtimit rus më 24 shkurt. OKB ka theksuar se edhe 759 civilë të tjerë janë plagosur. Të dhënat janë deri në mesnatën e së shtunës. Kjo zyrë përdorë metodologji strikte dhe vetëm raporton për numrin e viktimave të konfirmuara. Zyra për të Drejtat e Njeriut tha se shifrat reale vlerësohet se janë shumë më të larta, "veçanërisht në territorin e kontrolluar nga qeveria, veçmas në ditët e fundit", kjo për shkak se informacionet nga këto zona po vonohen që të arrijnë për shkak të luftimeve të vazhdueshme. Zyrtarët ukrainas kanë paraqitur një numër shumë më të lartë të civilëve të vrarë.

## Erdogani i kërkon Putinit ta shpallë armëpushimin në Ukrainë

Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, i ka kërkuar homologut të tij rus, Vladimir

Putin, që të shpallë armëpushim në Ukrainë, t'i hapë korridoret humanitare dhe të nënshkruajë një marrëveshje paqeje, ka njoftuar zyra e presidentit turk.

Pas një telefonate njëorëshe, presidenca turke përmes një deklarate njoftoi se Erdogani i tha Putinit se Turqia është e gatshme të kontribuojë në një zgjidhje paqësore të konfliktit. Sipas deklaratës, Erdogani tha se një armëpushim do ta lehtësonte situatën humanitare.

"Presidenti Erdogan filloi bisedën me fjalën: "le ta hapim rrugën për paqen së bashku", thuhet në deklaratën për medie. "Erdogani theksoi rëndësinë e ndërmarrjes së hapave urgjente për arritjen e një armëpushimi, hapjen e korridoreve humanitare dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje paqeje", thuhet më tej në deklaratë. Të dy krerët e shteteve diskutuan edhe për bashkëpunimin ndërmjet Rusisë dhe Turqisë.

Më herët presidenti Erdogan ka thënë se sulmi rus në Ukrainë "është i papranueshëm", mirëpo shteti i tij nuk do t'i kthejë shpinën asnjërit shtet, pasi me të dyja vendet ka lidhje të forta.

medimeve ndërkombëtare që ishin në qytetin Irpin, që gjendet në afërsi të Kievit, vrapuan për t'u larguar teksa bombardimet e forcave ruse vazhdonin. Bashkë me gazetarët u larguan edhe disa qytetarë.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se si pasojë e një sulmi me tetë raketa ruse është shkatërruar aeroporti në Vinistia në perëndim të vendit. Përmes një videoje të publikuar në "Twitter", ai sërish u bëri thirrje liderëve perëndimorë që të krijojnë një zonë të ndalimfluturimit mbi Ukrainë.

"Ne e përsërisim çdo ditë: Mbylleni qiellin mbi Ukrainë. Mbylleni për të gjitha raketat ruse, për avionët luftarakë rusë, për të gjithë ata terroristë. Krijoni një zonë ajrore humanitare. Ne jemi njerëz dhe kjo është detyrua juaj humanitare për të na mbrojtur ne, për t'i mbrojtur njerëzit. Ju mund ta bëni këtë. Nëse nuk e bëni, të paktën na jepni avionë që ta mbrojmë veten", tha ai.

Zelensky u ka kërkuar ligjvënësve amerikanë që Shtetet e Bashkuara të dërgojnë më shumë avionë për ushtrinë e tij dhe t'i ndërpresin importet e naftës ruse.



# Kosova dhe Serbia pritet të arrijnë marrëveshje për energjinë në veri dhe personat e pagjetur

Prishtinë, 6 mars - Kosova dhe Serbia pritet të arrijnë marrëveshje për energjinë në veri dhe për personat e pagjetur. Në takim të fundit më 22 shkurt palët i janë afruar gjuhës së përbashkët për këto dy tema. Përkitazi me këtë, Bashkimi Evropian (BE) pret që shumë shpejt të arrihet pajtimi dhe të fillohet diskutimi për normalizimin e plotë të marrëdhënieve.

Paralajmërimin për arritjen e një zgjidhjeje për energjinë në veri e ka dhënë edhe kryenegociatori i Kosovës në dialog, Besnik Bislimi.

Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë për "Kosovapress" se në takimin e fundit të kryenegociatorëve është diskutuar edhe për përgatitjen e terrenit për takimin e radhës të nivelit të lartë të dialogut Kosovë - Serbi. "Më 22 shkurt përfaqësuesi special i BE-së, Lajçaku, zhvilloi takime me dy kryenegociatorët, atë të Kosovës dhe atë të Serbisë, për një sërë çështjesh konkrete, me qëllim të diskutimit të çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjeve të kaluara, si dhe hapat e ardhshëm për normalizimin e marrëdhënieve me synim të përgatitjes së terrenit për takimin e radhës të nivelit të



lartë të dialogut. Pas 11 orësh negociata intensive, palët iu afruan gjetjes së gjuhës së përbashkët për disa çështje me rëndësi thelbësore për qytetarët e Kosovës dhe Serbisë, siç është rryma për veriun e Kosovës dhe zgjidhja e fatit të personave të pagjetur. Ne presim që palët të arrijnë shpejt një marrëveshje për këto çështje, për të lejuar fillimin e diskutimeve mbi tema të reja të rëndësishme për normalizimin e marrëdhënieve", ka thënë ai në një përgjigje me shkrim. Ndërsa sipas zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi, zgjidhja për energjinë në veri do të finalizohet shumë shpejt. "Në kuadër të

angazhimeve të deritanishme kemi përparuar dukshëm për gjetjen e një zgjidhjeje finale për energjinë në veri, problematikë kjo e trajtuar në kuadër të dialogut që nga viti 2013, por e pazgjidhur deri tani. Kjo temë është diskutuar me BE-në edhe në takimin e fundit. Pritjet tona janë që e njëjta të finalizohet shumë shpejt. Kjo do t'i hapte rrugë futjes në sistem legal gjithë shfrytëzuesve të energjisë duke vendosur parimin e barazisë... Për momentin jemi duke punuar për sigurimin e substancës së nevojshme për aranzhimin e takimit të radhës në nivel të krerëve të shtetit ku do të diskutohej për elementet

e marrëveshjes gjithëpërfshirëse", ka thënë ai në seancën e Kuvendit, në të cilën ishte debatuar për dialogun me Serbinë.

Nga ana tjetër, më skeptik për vazhdimin e dialogut dhe arritjen e ndonjë marrëveshjeje në rrethanat aktuale është profesori i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Enver Hasani. Ai ka thënë se dialogu do të pezullohet më shumë për shkak të zgjedhjeve në Serbi sesa agresionit rus në Ukrainë. Hasani ka shprehur kritika edhe për idenë e arritjes së një marrëveshjeje për mossulmim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Dialogu është i pezulluar jo për shkak të agresionit ndaj Ukrainës, por për shkak se në Serbi ka zgjedhje. Pala jonë ende është duke punuar për të arritur një konsensus. Ajo kryekëput diktohet prej (zgjedhjeve në Serbi) pasi nuk dihet me kë duhet të diskutohet deri në prill dhe duhet me pa kush e ka forcën politike atje... Pjesa e marrëveshjes së mossulmimit dhe ata tituj me pompozitet janë për konsum të brendshëm, por jashtë ato tingëllojnë qesharakë, siç edhe janë. Tingëllojnë anakronikë, veçanërisht tash. Ukraina dhe Rusia kanë nevojë për mossulmim dhe jo ne me Serbinë... Ajo është masë e

mirëbesimit dhe ato nuk kanë çfarë të ekzistojnë sepse ne si Kosovë nuk kemi ushtri efektive. Ne kemi ushtri në ndërtim e sipër, ligjërisht dhe faktikisht dhe pjesa e zonës (kufitare) me Serbinë është zonë e sigurisë që kontrollohet prej KFOR-it dhe nuk paraqet asnjë rrezik. Kjo masë e mirëbesimit mund vetëm të konstatohet, pasi ekziston", ka thënë ai.

Pas disa muajsh stopimi, delegacioni teknik i Kosovës dhe ai i Serbisë janë takuar në Bruksel më 22 shkurt, ndërsa është paralajmëruar edhe një takim para zgjedhjeve në Serbi më 3 prill. Arritjen e një marrëveshjeje për energjinë në veri e ka kërkuar edhe sekretari i shtetit të ShBA-së, Antony Blinken. "Ju inkurajoj që t'i kushtoni vëmendje arritjes së marrëveshjes për energji elektrike në veriun e Kosovës dhe për avancimin e qëllimeve të përbashkëta në lidhje me personat e pagjetur. Është në interes të Kosovës që këto çështje të zgjidhen dhe të çojnë drejt një zgjidhjeje kompromisi në planin afatshkurtër, e që të mund të shërbejnë si bazë për progresin e mëtejshëm drejt normalizimit gjithëpërfshirës", kishte shkruar Blinken në letrën dërguar kryeministrit Albin Kurti.

## Paralajmëron Uk Lushi: Serbia dhe Putini po përgatitin planin e ndërhyrjes në veri

PRISHTINË, 6 MARS - Në kohën e agresionit rus në Ukrainë, aktivisti shqiptar në ShBA, njëherësh ish-luftëtar i UÇK-së nga Batalioni "Atlantiku", Uk Lushi, ka paralajmëruar sulm të mundshëm të Serbisë në veri të Kosovës në bashkëpunim me Rusinë. Lushi, duke u thirrur në shërbime të inteligjencës, ka thënë se Serbia dhe Putini janë duke përgatitur planin e një

inkursioni në veri të Kosovës. Ai ka kërkuar nga NATO, KFOR-i, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe populli i Kosovës që të jenë gati. "Sipas disa shërbimeve të inteligjencës, Serbia dhe Putini janë duke përgatitur planin e një inkursioni në veri të Kosovës. NATO, KFOR-i, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe populli i Kosovës duhet të jenë gati", ka shkruar Lushi në "Twitter".





PËRFAQËSUES TË INSITUCIONEVE QENDRORE, LOKALE DHE PËRFAQËSUES  
TË PARTIVE POLITIKE KANË VIZITUAR PREKAZIN

# Porosia e bacës Rifat: Të gjithë bashkë të punojmë për zhvillimin e Kosovës

Përfaqësues të institucioneve qendrore, lokale dhe përfaqësues të partive politike kanë vizituar të dielën Prekazin me rastin e shënimit të 24-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes Jashari. Rifat Jashari ka pasur një porosi për të gjithë klasën politike. Ai ka thënë se të gjithë kanë dhënë për çlirimin e Kosovës, ndërsa tani të gjithë duhet të punojnë së bashku për zhvillimin e Kosovës

**EPOKA  
ERE**

**Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 6 MARS** - Në kuadër të shënimit të 24-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes Jashari, presidentja Vjosa Osmani, së bashku me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur lule në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Pas homazheve, të tre liderët e vendit dhe delegacioni që i shoqëronte, kanë vizituar

familjen Jashari, ku janë pritur nga Rifat Jashari, vëlla i komandantit legjendar Adem Jashari dhe anëtarë të tjerë të kësaj familjeje.

Duke i falënderuar për vizitën, Rifat Jashari tha se të gjithë kanë dhënë për çlirimin e Kosovës, ndërsa tani të gjithë duhet të punojnë së bashku për zhvillimin e vendit, që për lirinë e tij askush nuk kurseu asgjë.

Homazhe në Prekaz kanë bërë edhe përfaqësues të partive politike opozitare. Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se jemi sot këtu për ta përkujtuar sakrificën sublime të familjes Jashari në krye me

komandantin legjendar Adem Jashari, të cilët treguan trimëri të jashtëzakonshme në një situatë të jashtëzakonshme kur të gjithë ne si qytetarë të Kosovës ishim nën rrethimin gjenocidal të Serbisë. "Ata u sulmuan në shtëpinë e tyre. Shumica dërrmuese e familjarëve që u vranë ishin gra e fëmijë. Kjo tregon që kjo ishte ndër masakrat më të tmerrshme të kryera nga regjimi gjenocidal i Serbisë për të cilën, fatkeqësisht, ende nuk ka drejtësi. Por, përveç thirrjes sonë për drejtësi, ne gjithnjë do ta kemi udhërrëfyes të përhershëm trimërinë dhe sakrificën e familjes Jashari,



sepse ajo çfarë ata bënë për atdheun do të mbesë një dritë e cila do ta ndriçojë rrugën përpara të brezave të tërë. Prandaj, lavdi dhe përkujtimi i tyre do të jetë i përhershëm", ka thënë presidentja Osmani. Pas homazheve, kryetari Konjufca ka thënë se sakrificat e komandantit legjendar Adem Jashari dhe e familjes Jashari ishte një moment kur ajo kthehet në epike edhe kur i

gjithë kombi shqiptar mobilizohet dhe bëhet UÇK. Kreu i Kuvendit tha se ky moment jo vetëm që e ktheu të gjithë kombin në një ushtri dhe të gatshëm për ta dhënë jetën por, faktikisht, e shkundi të gjithë botën, duke e aktivizuar faktorin ndërkombëtar që të besonte në kauzën tonë të drejtë. "Nga ky kuptim mendoj se sakrificat e Jasharëve është momenti më

i rëndësishëm brenda përpjekjes çlirimtare të popullit të Kosovës për lirinë tonë. Lavdi e përjetshme Jasharëve! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!", ka thënë kryetari Konjufca. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se erdhën sot këtu në 24-vjetorin e flijimit të tre brezave të familjes Jashari të cilët u sakrifikuan për lirinë e Kosovës, e bashkuan popullin dhe i dhanë hov vendimtar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kurti ka thënë se ky nuk ishte sulmi i parë ndaj Jasharëve. Ata u patën sulmuar nga Serbia që udhëhiqej prej regjimit të Millosheviqit edhe në dhjetor të vitit 1991 edhe në janar të vitit 1998 dhe që të gjitha këto sulme ndaj Jasharëve ishin ndërmarrje e përbashkët kriminale e Serbisë. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë luftë mbrojtëse dhe drejtësi dhe e vërteta jonë nuk mund të tjetërsohen as nga deformimet që vijnë e as nga mohimet që bëhen. Gjenocidi i Serbisë në Kosovë i ka ende plagët e hapura dhe ne si institucione të Republikës, si krerë të këtyre institucioneve, si përfaqësues politikë, si qytetarë të Republikës, jo vetëm që nuk e harrojmë prej nga vijnë por, në të njëjtën kohë, pikërisht nëpërmjet përgjegjësisë sonë për këtë të shkuar, sa të dhimbshme aq edhe të lavdishme, e dimë se si të ecim mbarë dhe drejt përpara", ka thënë Kurti.

### Memli Krasniqi: Në Prekaz UÇK-ja e fitoi fuqinë për çlirimin e Kosovës

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i shoqëruar nga deputetë, anëtarë të kryesisë dhe shumë zyrtarë të tjerë të kësaj partie, kanë bërë homazhe në kompleksin e varrezave të familjes së komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari. "Sa herë që vijnë këtu, në Prekazin e lavdisë së përjetshme, veçanërisht me 5, 6 dhe 7 mars, në datat e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me nderim dhe përlulje e me respektin maksimal, e përkujtojmë luftën titanike dhe sakrificën sublime të kryekomandantit legjendar Adem Jashari dhe të gjithë familjes Jashari", ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se këto data kanë shënuar kthesën më të madhe në historinë e re të Kosovës, sepse jo vetëm kanë zgjuar vëmendjen e të gjithë botës, por edhe vetëdijen e gjithë kombit tonë, duke e vulosur të vërtetën se pa një kryengritje dhe një luftë të armatosur, populli i Kosovës nuk do të fitonte asnjëherë lirinë. "Andaj, pikërisht këtu në Prekaz, 24 vjet më parë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës e

fitoi fuqinë që e kërkonte për t'u bërë udhëheqëse e çlirimit të Kosovës, e më pas trasuese e rrugëtimit drejt pavarësisë dhe shtetit që e kemi sot. Ndërsa sot çdo vizitë në Prekaz na shërben për t'u frymëzuar secili prej nesh që kemi një detyrë e përgjegjësi publike, për të bërë punë të mira për vendin dhe për ta vazhduar ndërtimin e një shteti të zhvilluar, i cili i ofron perspektivë dhe dinjitet secilit qytetar të Kosovës. Edhe në këto momente do të kishim dëshirë t'i kishim pranë nesh edhe bashkëlufetarët e Adem Jasharit, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin, Jakup Krasniqin dhe të gjithë të tjerët që sot nuk janë këtu, por që po e vazhdojnë një betejë të re për të drejtën tonë, për të vërtetën dhe për historinë tonë", ka deklaruar Krasniqi.

### Abdixhiku: Datat 5, 6 e 7 mars janë të gravuara në themelet e lirisë së Kosovës

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, së bashku me anëtarë të kësaj partie, në 24-vjetorin e Epopesë së ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz duke kujtuar kështu sakrificën e familjes Jashari. "Datat 5, 6 e 7 mars janë të gravuara në themelet e lirisë së Kosovës. 24 vjet më parë, Drenica, Prekazi, familja Jashari ishin rrethuar nga forcat serbe. Në këtë rrethim e përballje disproporcionale forcash, Adem Jashari kishte zgjedhur mbrojtjen e pragut të shtëpisë - me gjithë familje. Kjo sakrificë e jashtëzakonshme e tyre në altarin e lirisë - ishte kushtim nacional për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte fillimi i fundit të okupimit serb mbi Kosovë. Sot vizituar Prekazin. Vizituar dhe bacën Rifat Jashari e anëtarët e tjerë të familjes Jashari. Kjo shtëpi e madhe e tyre vazhdon të jetë inspirim për ne. Sot nderojmë familjen Jashari; burrat, gratë e fëmijët që kishin rënë 24 vjet më parë, për të mos vdekur kurrë. Sot nderojmë të gjithë të rënë, martirët e viktimat e luftës e përpjekjes sonë për liri. Ky nderim, kjo sakrificë, na shërben si rikujtim i vazhdueshëm se sa i domosdoshëm është kontributi ynë i mbarë e i drejtë në liri", ka thënë lideri i LDK-së.

### Haradinaj: Epopeja e UÇK-së, ditë kujtimi dhe reflektimi për të gjithë shqiptarët

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, nga Prekazi ka



thënë se Epopeja e UÇK-së është ditë kujtimi dhe reflektimi për të gjithë shqiptarët. "Sot, në tempullin e lirisë, në Prekaz, nderuam ata me të cilët na bashkuan idealet, e trashëgimia e të cilëve vazhdon të na mbajë të bashkuar dhe të fortë. Jasharët gjithmonë u ndanë me lavdi, e armiku gjithëherë u kthye prapa me turp. Familje të tilla, rrallë sjell koha! Epopeja e UÇK-së, ditë kujtimi e reflektimi për të gjithë shqiptarët. Lavdi familjes emblematike Jashari! Lavdi të rënëve për liri!", ka thënë Haradinaj.

### Limaj: Më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 në Prekaz u ngritën themelet e shtetit tonë

Në ditën e dytë të Shënimit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, së bashku me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe në Prekaz. "Pikërisht më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 në Prekaz u ngritën themelet e shtetit tonë. Prekazi është vendi ku pavarësia dhe liria kanë marrë jetë dhe do të jetë obligimin ynë për të qenë në shërbim të lirisë dhe

pavarësisë së vendit tonë. Ne me pietet kujtojmë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Flijimi për liri i familjes Jashari është shembulli më unik i cili na kujton që, ajo që sot e gëzojmë, është rezultat i sakrificës së kësaj familjeje", ka thënë Limaj. Ai ka thënë se duke nderuar Epopenë dhe familjen Jashari nderojmë gjithë dëshmorët e rënë për lirinë e vendit tonë. "Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe gjithë dëshmorëve të kombit!", ka thënë Limaj.

## Mbi 1 000 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të dielën se prej 1 519 testeve, 46 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes.

Të dielën janë shëruar 187 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 222 371. Në total numri i rasteve aktive është 1 136.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës po trajtohen 35

pacientë, 19 pacientë të konfirmuar me Covid-19, 16 të tjerë negativë me post-Covid.

Me oksigjenoterapi janë 22 pacientë, kurse në Mjekim Intensiv janë të shtrirë 3 pacientë.

Në 24 orët e fundit janë

dhënë 190 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 815 707 doza të vaksinës.

Deri më sot 817 253 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



Deri më sot janë dhënë 98 150 doza përfunduese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

## Osmani: Anëtarësimi në NATO, parakusht për paqen në rajon



PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se shteti i Kosovës e ka objektiv kryesor anëtarësimin në NATO. Duke folur në ceremoninë që është mbajtur në kazermën "Adem Jashari" në shënimin e Epopesë së UÇK-së, Osmani tha se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) po rritet çdo ditë e më shumë.

Teksa ka përmendur luftën

në Ukrainë, ajo ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në NATO është i domosdoshëm që të ruhet paqja në rajon. "Anëtarësimi në NATO mbetet objektiv strategjik i shtetit tonë, andaj anëtarësimi është më i domosdoshëm se kurrë dhe është parakusht për paqen në rajon", ka deklaruar Osmani.

Presidentja Osmani ka thënë, po ashtu, se

"kërcënimet ndaj lirisë janë realitet që akoma po e përjetojmë". "Ne nuk duhet të heqim dorë asnjëherë nga përpjekja që shtetin ta mbajmë stabil. Si komandante supreme jam e bindur që ju ushtarë do ta bëni këtë dhe jeni gati për çdo situatë. Besoj fuqishëm se jeni gardianët tanë dhe çdo cepi të territorit tonë", është shprehur Osmani para ushtarëve të FSK-së.

## Sot në Prishtinë protestohet në mbështetje të Ukrainës

PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Situata në Ukrainë ka bërë që shumë vende të botës të dalin në protesta për t'u solidarizuar me popullin ukrainas dhe duke bërë thirrje për ndaljen e sulmeve nga ana e Rusisë. E një gjë të tillë do ta bëjnë sot (e hënë) edhe në Prishtinë qytetarët e Kosovës.

Organizatrat joqeveritare dhe institucionet e Republikës së Kosovës kanë organizuar tubim për në orën 12:00 në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë.

Njoftimin e ka bërë deputeti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi. "Shkatërrimi i infrastrukturës, pastrimi i fshatrave dhe qyteteve nga makineritë

ushtarake, radhët e gjata të njerëzve duke kaluar kufijtë për të qenë më të sigurt, janë kujtimi i freskët i luftës nëpër të cilën ka kaluar populli ynë. Andaj, në shenjë solidarizimi dhe përkrahje me popullin ukrainas, përfaqësuesit legjitimë të popullit ukrainas e në mbështetje të luftës së tyre heroike për mbrojtjen e lirisë dhe demokracisë, ju ftojme që të mblidhemi në sheshin 'Skënderbeu' në qendër të Prishtinës, ditën e hënë, me datë 7 mars 2022, në mesditë, në orën 12:00", thuhet në njoftimin për medie. Ai ka shkruar se në këtë tubim do të kërkohet ndalja e luftës dhe pushtimit të Ukrainës.



## Kurti: Serbia paraqet kërcënim direkt për rajonin, për paqen dhe sigurinë tonë



PRISHTINË, 6 MARS (ER) - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se derisa Serbia nuk pranon të nënshkruajë deklaratë mosulmimi e paqeje me Kosovën dhe nuk distancohet nga agresioni rus për pushtimin e Ukrainës, në të njëjtën kohë nuk u bashkohet demokracive të tjera për sanksionimin e Rusisë, ajo përbën kërcënim direkt për rajonin, për paqen dhe sigurinë

tonë afatgjatë e të përbashkët. Ai këto komente i ka bërë në mbledhjen e Këshillit të Lëvizjes Vetëvendosje. "Dënojmë ashpër edhe mosdënimin e agresionit rus dhe mosvënien e sanksioneve nga Serbia e cila kësaj po i bashkëngjitet Bjellorusisë. Nëse deri dje disa besonin se duke i ledhatuar autokratët zbuten ca e, ndoshta, bëhen demokratë, tashmë duhet ta kenë marrë

mësimin. Derisa Serbia nuk pranon të nënshkruajë deklaratë mosulmimi e paqeje me Kosovën, dhe nuk distancohet nga agresioni rus për pushtimin e Ukrainës, në të njëjtën kohë nuk u bashkohet demokracive të tjera në sanksionimin e Rusisë, ajo përbën kërcënim direkt për rajonin, për paqen dhe sigurinë tonë afatgjatë e të përbashkët", ka thënë Kurti.

# Një valë e re çmimesh pritet ta godasë tregun e Kosovës

PRISHTINË, 6 MARS - Një valë e re çmimesh nga tregjet e huaja pritet ta godasë edhe tregun e Kosovës për shkak të nisjes së pushtimit të Ukrainës nga Rusia, thonë ekspertë për çështje ekonomike.

Rusia është një prej prodhuesve më të mëdhenj të energjisë në botë dhe shpërthimi i luftës në Ukrainë ka çrregulluar tregjet e naftës dhe gazit në tërë globin.

Çmimi i naftës së papërpunuar Brent, më 6 mars, ka arritur në 118 dollarë për fuçi.

Rritja e çmimit të derivateve dhe energjisë në botë pritet që drejtpërdrejt t'i rrisë edhe çmimet e prodhimeve të tjera, pasi në Kosovë sasia më e madhe e mallrave importohet nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe ato të rajonit.

Çmimet e derivateve tashmë janë rritur. Në Kosovë, më 6 mars, një litër naftë është shitur për 1.59 euro centë, ndërkaq benzina 1.59 euro, varësisht nga operatori ekonomik dhe lokacioni. Kjo rritje ka shënuar nivelin më të lartë në 20 vjetët e fundit.

Po këto ditë në dyqane janë vërejtur edhe ngritje të çmimeve të prodhimeve bazë. Një litër vaj shitet nga 1.45 deri në 2.09 euro, një kilogram miell nga 0.69 deri në 0.95 euro dhe një kilogram sheqer nga 0.79 në 0.95 euro.

Profesori i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova nuk mund të jetë immune ndaj rritjes së çmimeve në tregjet evropiane për

shkak të importit. Ai ka thënë se tashmë ka edhe inflacion të lartë të çmimeve.

Në janar të këtij viti inflacioni arriti në 7.1 për qind. "Me këtë inflacion po përballen qytetarët e Kosovës. Për shembull, artikujt që para dy vjetësh janë blerë me 100 euro, vitin e kaluar nuk ka pasur mundësi të blihen me 200 euro. Ato prodhime, që më 2021 janë blerë me 200 euro, sot paguhen 270 euro. Vërtet kjo është shqetësuese", ka thënë Gërxhaliu.

## Çmimet e prodhimeve në tregun e BE-së do të arrijnë në Kosovë

Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj, ka thënë se ndikimet e luftës Rusi - Ukrainë do të vërehen edhe te çmimi i drithërave. Sipas tij, Kosova ka bilanc tregtar negativ pasi më shumë importon sesa eksporton, dhe efektet e krizës, thotë ai, do të jenë të ashpra. "Përveç në naftë dhe në energji elektrike, ndikimet e para do të vërehen edhe te lënda e parë dhe drithërat, respektivisht ushqimet, sepse dihet mirë fakti se Ukraina merr pjesë me një sasi të madhe të drithërave në tregun global", ka thënë Ramosaj.

## "Paniku" për miell

Ukraina llogaritet të jetë një prej eksportuesve më të mëdha të

miellit në botë.

Me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve nga lëvizja e çmimeve, Safet Gërxhaliu ka konsideruar se Qeveria e Kosovës duhet të ndërhyjë në forma të ndryshme te sektori privat. "Duhet të ketë ndërhyrje në formë të akcizës apo tatimeve dhe bashkërisht ta tejkalojmë këtë situatë, e cila është mjaft sfiduese jo vetëm për Kosovën, por për gjithë botën. Po e them me përgjegjësi se efektet e luftës në mes të Ukrainës dhe Rosisë janë shumë më të mëdha sesa të gjitha dëmet që ka shkaktuar pandemia Covid-19 në gjithë botën", ka thënë ai.

Deri më tani Qeveria e Kosovës ka vendosur marzhë tregtare vetëm për derivatet e naftës si formë për ta ruajtur mundësinë e çrregullimeve në treg. Sipas këtij vendimi, marzha më e lartë tregtare të jetë deri në 4 për qind të çmimit të shitjes, ndërkaq te shitësit me pakicë marzha më e lartë deri në 6 për qind.

## Shkëmbimet tregtare të Kosovës me Rusinë dhe Ukrainën

Vetëm gjatë vitit 2021, sipas të dhënave zyrtare, mbi 4.6 miliardë euro ka qenë vlera e prodhimeve të importuara në Kosovë, ndërsa shumë më pak, 712 milionë euro, ka qenë vlera e eksporteve.

Kosova importon kryesisht nga Bashkimi Evropian dhe nga

vendet nënshkruese të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA): Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnje e Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia.

Kosova nuk ka shkëmbime të larta tregtare me Rusinë dhe Ukrainën.

Sipas të dhënave të Doganave të Kosovës, vitin e kaluar vlera e importit nga Rusia ka qenë mbi 50 milionë euro, kurse gjatë këtij viti, deri më 27 shkurt, në tregun e Kosovës mallra ruse kanë hyrë në vlerë prej 5.4 milionë eurosh.

Pijet alkoolike, tekstili, vajrat, letra, sheqeri, kimikatet organike, prodhimet e qelqit janë vetëm disa nga prodhimet ruse që gjenden në tregun e Kosovës, ndërsa vlera e prodhimeve të Kosovës që kanë kaluar në tregun e Rosisë vitin e kaluar ka qenë mbi 34 mijë euro, ndërsa gjatë këtij viti mbi 3 mijë euro.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë janë të regjistruara vetëm gjashtë kompani ruse, apo kompani me pronarë me shtetësi nga Rusia. Ndërkaq, në pesë vjetët e fundit nuk ka pasur ndonjë investim direkt.

Ndërsa prodhimet nga Ukraina në tregun e Kosovës kanë pjesëmarrje edhe më të vogël. Më 2020 vlera e mallrave ukrainase të importuara në Kosovë ka qenë rreth 19 milionë euro, ndërsa vitin e kaluar kjo vlerë gati është dyfishuar me mbi 36 milionë euro.

Miell, kafe, çaj, vaj, tekstil,

qeramikë janë disa nga prodhimet e importuara vitin e kaluar nga Ukraina në Kosovë. Mallrat që Kosova ka eksportuar në Ukrainë në vitin 2021 kanë kapur vlerën e mbi 22 mijë eurove, ndërsa në vitin 2020 mbi 70 mijë euro.


## Kriza në tregjet ndërkombëtare prek paratë e Trustit


Prishtinë, 6 mars - Vlera e investimeve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, sipas zyrtarëve të këtij institucioni, ka shënuar humbje rreth 90 milionë euro. Humbjet kanë ardhur si pasojë e krizës në tregjet ndërkombëtare të shkaktuar nga ndërhyrja ushtarake e Rosisë në Ukrainë.

Nga Fondi i Kursimeve Pensionale, prej mbi 2.3 miliardë euro, 78 për qind e mjeteve janë të investuara në tregjet financiare ndërkombëtare dhe rreth 22 për qind në Kosovë.

Fondi prej mbi 2.3 miliardë eurosh u takon mbi 700 mijë kontributpaguesve të Kosovës. Jeton Demi, zëdhënës në këtë institucion, ka thënë se pas ngritjes së vlerës së këtij fondi për 11 për qind në vitin 2021, aktualisht po shënohen humbje.

"Rënia e vlerës së investimeve të Fondit Pensional është e pritshme. Aktualisht kemi një reduktim prej 4-përqindësh të vlerës", thotë Demi.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Ballkani fiton derbin ndaj Llapit, Drenica fiton kundër Dritës

**SUHAREKË, 6 MARS** - Të dielën janë zhvilluar tri ndeshjet e fundit të javës së 23-të në BKT Superligë të Kosovës në futboll. Skuadra lidere, Ballkani, ka realizuar fitoren e radhës, duke e mundur Llapin, me rezultat të ngushtë, 1:0, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin e qytetit në Suharekë. Golin e fitores e shënoi sulmuesi i krahut, Ermal Krasniqi, në minutën e 75-të. Me këtë fitore Ballkani mbetet lider me 48 pikë të mbledhura, dy më shumë se skuadra e Gjilanit që renditet i dyti. Kjo e fundit ka arritur fitore në duel me Ulpianën, me shifrat 2:0, me golat e realizuar nga Gerhard Progni (54') dhe Shend Kelmendi (75'). Ndërkohë, Drita ka

pësuar humbje në Skenderaj në duel me Drenicën, me rezultat 2:1. Fatlum Gashi (8') e Kreshnik Uka (45'+1) nga penalltia shënuan për Drenicën, derisa golin e nderit për Dritën e shënoi Almir Kryeziu (46'). Ndërsa Dukagjini ka shënuar fitore të rëndësishme në përballje me Prishtinën në stadiumin "18 Qershori" në Klinë, me rezultat 2:1. Golat për fitoren e skuadrës së drejtuar nga Armend Dallku i shënuan Mentor Zhdrella në minutën e 10-të dhe Altin Merlaku nga penalltia në minutën e 44-t, derisa golin e vetëm për Prishtinën e realizoi Mendurim Hoti në minutën e 17-të. Pas kësaj fitoreje Dukagjini ngjitet në vendin e



tetë, me 24 pikë, derisa Prishtina renditet në pozitën e gjashtë me 26 pikë. Në anën tjetër, Malisheva ka realizuar fitore të pritur në duel me Feronikelin, në stadiumin "Limani Gegaj", me rezultat 6:1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Laurant

Xhylanit (18'), por më pas Malisheva realizoi seri të golave nëpërmjet Mërgim Pefqelit 43', Yoan Marc-Olivier 55', Agon Xhakës 70', Ronald Sobowale 72', 76' dhe Ilir Mustafës 87'. Malisheva pas kësaj fitoreje ndodhet në pozitën e shtatë, me 26 pikë.

### BKT SUPERLIGA

Ballkani - Llapi	1-0
Drenica - Drita	2-1
Gjilani - Ulpiana	2-0
Dukagjini - Prishtina	2-1
Malisheva - Feronikeli	6-1

### TABELA

	PIKË
1. Ballkani	48
2. Gjilani	46
3. Drita	41
4. Llapi	39
5. Drenica	31
6. Prishtina	26
7. Malisheva	26
8. Dukagjini	24
9. Ulpiana	22
10. Feronikeli	11

## Prizreni 16 fiton përballjen dramatike në kryeqytet

**PRISHTINË, 6 MARS** - Prizreni 16 ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës në kryeqytet me rezultat 75:78 (20:25, 20:22, 14:14, 21:17), në kuadër të xhiros së 21-të të Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll. Fillimi i ndeshjes ishte interesant me një epërsi të lehtë të mysafirëve, ndërsa më pas vendasit ngushtuan shifrat në 12:13, kur filloi një seri prej 0:7 e prizrenasve për 12:20, kurse çereku i parë përfundoi me shifrat 20:25. Periudhën e dytë më mirë e nisën kryeqytetasit që arritën

të kalojnë në epërsi 29:27, e më pas zhvillohet lojë me kthesa, ku herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, por në fund, basketbollistët e Prizrenit 16 sërish shkëputen për të shkuar në pushim me shifrat 40:47. "Bardhekaltrit" nuk dorëzohen dhe në periodën e tretë arrijnë të ngushtojnë shifrat në 50:52, megjithatë, prizrenasit sërish shkëputen në 52:61, ndërsa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 54:61. Çereku i fundit ishte dramatik, me prishtinasit që nuk dorëzohen

dhe barazojnë shifrat në 75:75, 0:27 sekonda para fundit, por në momentet vendimtare, Prizreni 16 ishte më i vëmendshëm dhe triumfoi 75:78. Te Sigal Prishtina u dalluan Meriton Ismaili me 17 pikë e gjashtë kërcime dhe Wendell Mitchell me 22 pikë, kurse te Prizreni 16 u dalluan Urim Zenelaj me 19 pikë e 12 kërcime dhe Darell Davis me 26 pikë e 10 kërcime. Sigal Prishtina ka 10 fitore e 11 humbje, kurse Prizreni 16 ka 13 fitore e gjashtë humbje.



## Llapi pëson humbje nga Rahoveci



**PODUJEVË, 6 MARS** - Rahoveci e ka fituar ndeshjen përmblyëse të xhiros së 18-të, përkatësisht të pjesës së rregullt të kampionatit në Superligën e Kosovës në hendboll. Të dielën në Podujevë, Rahoveci fitoi ndaj Llapit vendas me rezultat të ngushtë, 36:34. Vreshtarët në

pjesën e parë kishin epërsi të vazhdueshme, ndërsa pas 30 minutave lojë rezultati ishte 18:13 për Rahovecin. Edhe pjesa e dytë vazhdoi njëjtë, ndërsa në fund vendasit u afruan në dy gola. Elion Vokshi ishte më efikas te Rahoveci me 11 gola. Alban Haziri shtoi nëntë. Blerton

Hasani shënoi dhjetë gola për Llapin. Nëntë i kishte Artir Muçiqi, kurse tetë i realizoi Endrit Havolli. Rahoveci e mbyll pjesën e rregullt në pozitën e katërt me 24 pikë. Do të vazhdoi garimin në Superligën A. Llapi renditet i teti me 10 pikë dhe vazhdon garën në Superligën B.

## City triumfon në derbin e Manchesterit

**MANCHESTER, 6 MARS** - Manchester City ka konfirmuar se "qyteti" është i tyre, pasi mposhti me rezultatin 4-1 në derbi rivalët e Manchester Unites, duke çuar në 6 pikë diferencën me Liverpoolin

që ka një ndeshje më pak. Skuadra e Pep Guardiola dominoi, ndërkohë që mesfushori Kevin De Bruyne e zhbllkoi ndeshjen që në minutën e pestë, me një goditje nga brenda zone. Unitedi reagoi dhe në

minutën e 22-të barazoi, me një gol fantastik të Jadon Sancho. City gjithsesi nuk u pezmatua, pasi sërish me mesfushorin belg e çoi topin në rrjetë dhe e mbylli pjesën e parë në epërsi 2-1. Goli i tretë i City ishte fantastik,

me Mahrezi që shënoi pas një skeme të bërë nga goditja e këndit. I njëjti lojtar e çoi topin në rrjetë edhe në minutat shtesë. VAR ia konfirmoi golin dhe City vazhdon rrugën drejt titullit kampion.





U bënë tri vite pa më të dashurin tonë



## Zenel (HALIL) Ahmeti

(13.05.1936 – 06.03.2012)

Vështir qenka të shkruaj për te përkujtuar ty Babë, 3 marsi 2012 është një ndër datat më të dhimbshme për ne, mëngjesi i asaj dite ishte shumë i rënd për mua, në vend se të pimë kafën e mëngjesit se bashku e te çmallemi me ty, ti atë ditë u shtrive në spital nga një sulm në zemër dhe shkove në botën e amshueshme përgjithëmon dhe u ndave nga ne pa na thënë lamtumirën e fundit. Edhe ky Mars erdhi shumë i zyrtë pa ty, zemrat tona janë të heshtura, dielli është errësuar, shiu pikon se bashku me lotët tonë nga dhembja që kemi për ty, buzëqeshja nuk ka vend tek ne, por na mbajnë gjallë fjalët e tua, veprat, këshillat dhe krenaria që patëm një prind, një familjar si ty e që na mësove vetëm gjëra të mira.

Me mall të përkujton: Vajza Lumnija dhe bashkëshorti Ilmi Veliqi me familje.

Sot me 06.03.2022 bëhen 10 vite nga vdekja e më të dashurit tonë



## **Zenel (HALIL) Ahmeti**

(13.05.1936 – 06.03.2012)

Babë, kaluan 10 vite nga dita kur ike përgjithmonë.

Koha kaloi shumë shpejt por mungesa dhe malli për ty vetëm sa na është shtuar.

Shkove si një engjell në qiell e ne na mbetën vetëm kujtime e tua të cilat i kujtojmë çdo ditë.

Babë të kujtojmë duke menduar që sikur të ishte në mesin tonë e t'i shohësh nipat dhe mbesat e tua, sa lumturi dhe dashuri i kanë dhënë familjes tonë, do të ishte një babagjysh i mrekullueshëm për ta, ashtu qysh ishte edhe për fëmijët e tu.

**Te përkujtojm me mall: Bashkëshortja Ajetja me djemt Sejdin, Brahimin, vajzat, nipat dhe mbesat.**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:165 /1  
Dt:03.03.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### RI-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendër e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkollë	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtina	Një mësimdhënës/e për lëndë profesionale të makinerisë me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike me 10 orë mësimore.	Vend i lirë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
  - Letërnjoftimi (fotokopje);
  - Certifikata për trajnimet e kryera;
  - Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
  - Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
  - Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
- Afati i konkurrimit është 3 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë.
  - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
  - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
  - Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

# NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

#### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Rina Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Abdul Frasher" Prizren.

► Florim Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vërmicë.

► Abit Shatri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Bajram Curri" Romajë.

► Blerand Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SHFMU "Yll Morina" nga klasa e -I- deri -V-, dhe -VI-IX-, Gjakovë.

► Liridona Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SHFMU "Ukshin Miftari", Skivjan nga klasa nga klasa e -I- deri -V-, dhe -VI-IX-.

► Musë Gjini shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -III- dhe -IV- si dhe diplomën e QAMO "Hysni Zajmi" drejtimi - Ndërtimtari, Gjakovë.

► Musë Gjini shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -I-, dhe -II- të Gjinnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

